



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Tiranë, Datë 12/11/2007

Njoftim për shtyp

Mbi Hapjen e Hetimit Të Përgjithshëm në Sektorin e Energjisë

Në mbledhjen e ditës së sotme, Komisioni i Konkurrencës vendosi hapjen e një hetimi të përgjithshëm në sektorin e energjisë. Ky hetim mbështetet në nenin 41 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe do të shtrihet në të gjithë sektorin e energjisë.

Raporti i hetimit do të sjellë një pasqyrë të plotë të situatës së konkurrencës në këtë treg duke evidentuar problemet e mundshme.

Ky vendim ka ardhur pas një studimi të Tregut të Hidrokarbureve nga ana e Sektorit të Analizës dhe Studimeve të Autoritetit të Konkurrencës dhe monitorimet e kryera nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, ku ka rezultuar se ka shenja të kufizimit dhe shtrembërimit të konkurrencës duke mos reflektuar çmime të një konkurrence efektive në treg.

Hapja e një hetimi për këtë sektor merr një rëndësi të madhe pasi tregu i energjisë mbetet një nga sektorët kryesorë të ekonomisë për shkak të rolit që ka në përcaktimin e kostos së aktivitetit të sipërmarrjes, efikasitetit të ndërmarrjeve dhe shërbimeve publike dhe në përgjithësi kostos dhe cilësisë së jetës së konsumatorëve.